



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA INTEGRIMIT EUROPIAN DHE DIASPORËS

Nr. 4830 Prot

Vlorë, më 16.05 2024

PROCESVERBAL

KONSULTIM ME PUBLIKUN PËR REDUKTIMIN E ZHURMAVE PËR BASHKINË
VLORE

Data: 16.05.2024 ora 17.30
Vendi: Pallati i Kulturës "Labëria"

Baza ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" neni 18; ligjit nr.119/2014 "Per të drejtën e informimit", ligjit nr.146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë.

Marrin pjesë:

Ermal Dredha- Kryetar i Bashkisë Vlorë, Elpiniqi Mërkuri-Kryetare e Këshillit Bashkiak, Aulona Veizi- Drejtore i Drejtoria e Bujqësisë, Mbrojtjes së Mjedisit, Veterinerisë, Pyje dhe Kullota, përfaqësues nga administrata e bashkisë, përfaqësues nga bizneset, përfaqësues nga komuniteti dhe media lokale.

Takimin e hapi kryetari Bashkisë Vlorë z.Ermal Dredha: Përshëndetje dhe ndjesë për vonesën. Takimi sot është për përcaktimin e zonave me muzikë. Udhëzimi është deri në orën 12.00 të natës. Në takimin me Ministren e Turizmit, u diskutua edhe parashikimi për zonat me muzikë të lartë, që mos të shqetësohen edhe të tjerët që duan pushim. Parametrat të respektohen dhe të mos të ketë shqetësim. Aparati që mat zhurmën, policia e shtetit, te gjitha masat, kur tejkalojnë zhurmat me muzike live. Për më tepër do prezantoj detajet Aulona.

Aulona Veizi- Përshëndetje. Sipas legjislacionit në fuqi, Ligji nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", i ndryshuar me Ligjin nr. 39/2013, Ligji për Ligji nr. 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore, përcaktojnë detyrimin institucional për planin e veprimit të bashkisë për menaxhimin e zhurmave. Ka 2 vjet që është hartuar plani në bashkëpunim me organizatën. Drejtoria e bujqësisë ka specialistin e mjedisit edhe për zhurmat. Kemi hartuar planin e veprimit, qyteti është në zhvillim, porti, aeroporti, plani vendor i

azhornuar. Lidhur me planin, janë marrë në konsideratë, konventat e BE-së për mjedisin, menaxhimin e zhurmave, kuadri ligjor për mbrojtjen e mjedisit, masat për ndotjen akustike. VKB, VKM baza ligjore, percaktojnë maksimumin dhe minimumin e ndotjes akustike. Mjediset publike, ceremonitë sipas ligjit në minimumin dhe maksimumin si dhe kufizimet. Planet e zhurmës miratohen nga VKB. Organet e kontrollit monitorojnë. Kemi pajisje modeste për nivelin e zhurmave, ka pika monitorimi, te Xhamia, Lungomare, Plazhi i Vjeter. Janë vlerësuar nivele të larta të zhurmave. Në metodologji u shpërndanë 700 pyetësor fillimisht për matjen e perceptimit qytetar mbi nivelet e zhurmave përgjatë bashkisë Vlorë me një fokus në zonën bregdetare. Më pas u bë formulimi i konkluzioneve dhe rekomandimeve në formën e një studimi me qëllim zhvillimin e plotë të planit të zhurmave dhe integrimin e gjetjeve në politikat lokale. Plotësimi i pyetësorëve në Bashkinë Vlorë u realizua përgjatë muajve Tetor - Dhjetor 2023.

Metodologjia e monitorimit të zhurmave (57 stacione monitorimi në Vlorë) (9 stacione monitorimi të Plazhi I vjeter). Muaji Gusht-shtator 2023.

Sipas të dhënave nga pyetësorët dhe metodologjisë së ndjekur, qytetarët nuk kanë info mbi nivelin e zhurmave dhe ndotjes akustike.

Sezoni do masa konkrete shtesë për monitorimin e situatës së menaxhimit të zhurmave me grupe pune të përbashkëta.

Plani i masave me drejtoritë përkatëse në bashkinë Vlorë si propozohet është:

Policia bashkiake për këshillimin dhe penalizimi në raste shkelje, si dhe vendosjen e sinjalistikës së nevojshme për kufizimin e shpejtësisë në rrugët dhe zonat më problematike.

Drejtoria e Informimit për promovimin e masave për kontrollin e zhurmave si dhe vendosjen e tabelave elektronike sensibilizuese për nivelin e zhurmave.

Drejtoria Bujqësisë, Mbrojtjes së Mjedisit, Veterinarisë, Pyje dhe Kullotave, mbjelljen e korridoreve ekologjike me pemë të përshtatshme për strukturën e tokës midis rrugës automobilistike dhe banesave me qëllim reduktimin e nivelit të zhurmave në banesa .

Edukimi dhe realizimi i fushatave të ndergjegjesimit me nxënësit e shkollave për reduktimin e zhurmave.

Hartëzimi hap pas hapi sipas rasteve.

Ermal Dredha: Cfarë shqetësimi keni? Aparaturat dhe muzika, infrastruktura, nëse plotësohen dhe zbatohen kriteret e përcaktuara s' do ketë shqetësime. Biznesi të plotësoj kriteret. Ndotja akustike është shqetësim. Plani i menaxhimit të zhurmave do të kaloj në KB.

Qytetar; ky kufizim ka 1 vit e gjysëm, rregullatori duhet për mbarëvajtjen e punës dhe mos të kemi probleme. Duam të ketë gjallëri, bizneset të respektojnë kriteret. Në celjen e sezonit ishin 7-8 artistë të njohur. Rregullatori i muzikës së lartë, ndotje akustike ka. ATA ka kërkuar aktivitete, qytetarët dhe turistët, zona e Lungomares ka zhurmë në nivele të larta. Kur kërkojnë të blejnë shtëpi, kur duan qetësi mos të blejnë shtëpi ne Lungomare.

Ermal Dredha: Një qytet si Vlora, muzika është gjallëri dhe gjithandej, por nuk duhen cënuar komshijtë që duan qetësi. Ka miksime muzikash të cilat më shumë sjellin vuajtje nga zhurmat që krijojnë. Izolimi akustik ka ndikim. Marina ka marrë përsipër për mos të patur ndotje akustike, investimet që kanë zhvillimin ekonomik duke respektuar të tjerët. Sipas kërkesave pas orës 12.00. Të respektohen kriteret. Jua bëjnë punën e lehtë, të mos kalojnë cakun.

Qytetar: Vin polici te dera e lokalit për muzikë, kjo nuk lë shije të mirë për turistët. Në nivelin që e kemi vendosur.

Aulona Veizi: Është e parashikuar në ligj, që në orën 12.00 të natës të jetë muzikë e qetë, sipas pajisjeve amortizuese që parashikon ligji dhe nuk krijon ndotje akustike. Ligji e certifikon pajisjen, oraret do caktohen së bashku.

Qytetari: Jam dakort por jo të flemë në orën 12. Kemi biznese, jeta është zhurmë dhe do muzikë. Të ketë orar shtesë nga 12,30 deri në orën 1.30 të natës, 1 orë shtesë dhe jemi ok. Kaq kërkojmë. Gjatë javës 11.30-12.30 dhe në fundjavë 12.30-1.30.

Ermal Dredha: Do i shikojmë së bashku.

Qytetar: Faleminderit që keni mundësi të dëgjohemi për këtë problem. Duam rregulla dhe ti zbatojmë. Për të gjithë ne është një hap i madh për qytetin. Është rregull që vendosin sot për 10 vjet. Ora 1.00 e natës. Interesi i Policisë për të ruajtur rendin dhe qetësinë, kriteret për 110db, orari të respektohen. Dakortësojmë të gjithë dhe të mos abuzojmë. Gjysëm ore e kemi kërkuar gjithmonë.

Ermal Dredha: Cfarë do investoni?

Qytetari: Sitem me boxe pasiv, pa zhurmë, afër banesave nuk ka zhurmë. Kushton shumë por e kemi marr dhe instaluar. Zhurma nuk del jashtë. Do vendoset dhe do menaxhohet edhe në ambientet e hapura. Edhe pse ka kosto 200 mije euro për pajisjen.

Qytetar: Dua muzikë, e drejta mbi individin. Ligji duhet taksativ. Të respektojmë njëri tjetrin. Bëjmë takim për orarin, nuk funksionon, duhet sipas ligjit. Zhurma e makinave dhe të tjera.

Ermal Dredha: Si bashki do vendosim bashkë për kërkesat tuaja dhe hartëzimin. Hapi i parë.

Qytetari: Orikum- Vlorë, shërbim urban deri vonë për qytetarët dhe turistët si dhe rruga.

Ermal Dredha: Do i iniciojmë, po merremi. Për rrugën do angazhohemi të mbaroj deri në qershor jo vetëm Bypassi. Jemi në kontakt. Investimi për ujin e pijshëm. Rrugët kryesore të rregullohen ku janë çarë. Tubacionet për ujin e pijshëm, rrjeti të funksionoj si duhet. Akset kryesore të gjejnë zgjidhje. Projekti dhe investimi do cohet në të gjithë Vlorën, rrugët do kthehen në gjendjen e mëparshme sipas premtimeve. Ndjesë për situatën tani, por në fund Vlora do ketë ujë të pijshëm kur të mbaroj projekti.

Faleminderit për pjesëmarrjen!

Konceptoi: Albana Naçi



Koordinatorë për Njoftimin dhe Konsultimin Publik